



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE

Nr. 8800 Prot., datë 10 . 12 . 2020

Nr. 1549 Prot., datë 10 . 12 . 2020

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 463 datë 10 . 12 . 2020

**“PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE DHE ORGANEVE QË MARRIN TË  
DHËNA PERSONALE NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE, SI DHE MËNYRËN,  
LLOJIN DHE SASINË E INFORMACIONIT QË DUHET TË MARRIN”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 2, 2/1 dhe 3 të nenit 3, të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile” i ndryshuar, si dhe shkronjës “k” të pikës 1 të nenit 31 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

1. Institucionet, organet, personat juridik publikë (kontrolluesit publikë), mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltarë dhe nga aktet e gjendjes civile, nëse kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin përcaktohet në Aneksin I të këtij udhëzimi.
2. Informacioni sipas Aneksit I, përcillet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, siç parashikohet rast pas rasti në këtë aneks.
3. Personat juridik apo fizik privat (kontrolluesit privatë), mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltarë dhe nga aktet e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse marrin pëlqimin me shkrim nga ana e subjektit të të dhënave. Përfundim nga ky rregull bëjnë vetëm rastet kur një përpunim i tillë i të dhënave personale nga kontrolluesit privatë, autorizohet nga dispozitat e legjislacionit në fuqi.

4. Për marrjen e informacionit në rrugë elektronike, kriteret dhe kushtet konkrete përcaktohen në marrëveshje dypalëshe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe kontrolluesit përkatës dhe/ose sipas parashikimeve të tjera të legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, marrëveshjet në fjalë rregullohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5. Për marrjen e informacionit në formë shkresore, kontrolluesit i drejtohen me kërkesë të motivuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, ose zyrës përkatëse të gjendjes civile, që administron dokumentacionin, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.
6. Kërkesat drejtuar shërbimit të gjendjes civile, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, duhet të shoqërohen me formularin sipas Aneksit III, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në të cilin subjekti i të dhënave personale ka shprehur pëlqimin e tij.
7. Përjashtohen nga rregulli i përcaktuar në pikën 6 kontrolluesit të cilët autorizohen me ligj për të përpunuar të dhënat personale të subjekteve të të dhënave personale për qëllime të veprimtarisë së tyre.
8. Kontrolluesit që kërkojnë të dhëna personale duhet të shprehin qartë bazën ligjore, mbi të cilën mbështesin kërkesën e tyre, qëllimin për të cilin do të përdoren këto të dhëna, si dhe llojin e të dhënave që kërkojnë. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor.
9. Kërkesa për marrjen e të dhënave personale bëhet duke plotësuar formularin "*Kërkesë për marrjen e të dhënave personale*", sipas Aneksit II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
10. Kontrolluesit, që marrin të dhëna personale, në asnjë rast nuk duhet t'i përhapin ato tek pale të treta, pavarësisht faktit se këto të fundit mund të jenë të legjitimuara për t'i përpunuar këto të dhëna. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vetëm rastet e parashikuara me ligj.
11. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile regjistrojnë të gjitha kërkesat, duke evidentuar datën kur është paraqitur kërkesa, kontrolluesin që kërkon të dhëna personale, të dhënat që kërkohen të përpunohen dhe ato të cilat janë dhënë ose jo, si dhe qëllimin e deklaruar nga kontrolluesit në fjalë për përpunimin e këtyre të dhënave. Këto informacione i jepen, sipas kërkesës, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mund t'i përdorë për qëllime hetimi administrativ dhe/ose për qëllime statistikore.
12. Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përditësojnë Aneksin I, në mënyrë periodike dhe/ose brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës së një kontrolluesi të caktuar për t'u përfshirë në këtë aneks.



13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, dhe strukturat e saj në nivel vendor, si dhe të gjithë institucionet, organet, personat juridik apo fizik që përpunojnë të dhëna personale në bazë të këtij udhëzimi.
14. Udhëzimi nr. 95, datë 07.04.2014 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BRENDSHËM**

**Sandër Lleshaj**



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E  
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

**Besnik Dervishi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

ANEKSI I

LISTA E INSTITUCIONEVE QË MARRIN INFORMACION, BAZA LIGJORE PËRKATËSE, LLOJI DHE SASIA E INFORMACIONIT QË JEP SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE DHE MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË KËTIJ INFORMACIONI NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR.189, DATË 04.10.2022<sup>1</sup>

NR.	SUBJEKTET (KONTROLLUESIT) QË MARRIN TË DHËNA	BAZA LIGJORE	TË DHËNAT PERSONALE QË DUHET TË JEPEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN PËRKATËS PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË INFORMACIONIT TË KËRKUAR
1	Agjencia e Trajtimit të Kredive	Ligji nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, Neni 10	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
2	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)	Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, neni 68 “Bashkëpunimi ndërinstytucional”;  Ligji 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, Neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”.	Të dhënat që përmban certifikata e lindjes dhe certifikata familjare.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

<sup>1</sup> Ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.189, datë 04.10.2022, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” të Ministrisë së Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3	<b>Autoritetet tatimore</b>	<p>Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 62 “Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion”</p> <p>Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Neni 13 “Detyrimi për të paguar” deri 13/10</p> <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 14.12.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, pika 5.4</p> <p>Udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.8</p>	<p>Të dhënat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Emër;</li> <li>- Mbiemër;</li> <li>- Numri personal;</li> <li>- Atësi;</li> <li>- Amësi;</li> <li>- Vendbanimi (adresa).</li> </ul>	Në formë elektronike.
4	<b>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)</b>	<p>Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Neni 14 “Kompetencat e Bordit”, pika 2 dhe 22</li> <li>- Neni 15 “Kompetencat e kryetarit të Bordit”,</li> <li>- Neni 18 “Procedura e ekzekutimit të të drejtave të Bordit dhe të strukturave të Autoritetit”, pika 6, paragrafi 4.</li> </ul> <p>Ligji nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, neni 38 “Krijimi i qendrës së informacionit të sigurimeve dhe lloji i të dhënave që duhet të administrojë”.</p>	<p>Të dhënat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Emër;</li> <li>- Mbiemër;</li> <li>- Atësia</li> <li>- Numri personal;</li> <li>- Datëlindje;</li> <li>- Gjinia;</li> <li>- Vendbanimi (adresa).</li> </ul>	Në formë elektronike.
5	<b>Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit</b>	<p>Neni 5, i ligjit Nr.45/2015, datë 30.04.2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Emri;</li> <li>- Mbiemri;</li> <li>- Numri personal;</li> <li>- Atësia;</li> <li>- Amësia;</li> <li>- Gjinia;</li> <li>- Datëlindja;</li> <li>- Vendlindje (qyteti, fshati);</li> <li>- Vendbanimi (adresa);</li> <li>- Gjendja civile;</li> <li>- Mbiemri para/pas martesë;</li> <li>- Shtetësia;</li> <li>- Bashkia/Njësia Administrative;</li> <li>- Historikun e gjeneraliteteve të ndryshme gjatë viteve për periudhën kohore nga viti 1941-1991”</li> </ul>	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
6	<b>Avokati i Popullit</b>	<p>Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Neni 19 “Procedura e hetimit”</li> <li>- Neni 20 “E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekrete shtetërore”</li> </ul>	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, por që kanë lidhje me hetimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.

7	<b>Avokatura e Shtetit</b>	Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar; Neni 16 “Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuara në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
8	<b>Banka e Shqipërisë</b>	Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, pika 1, e nenit 24 dhe shkronja a), e nenit 29.	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numri Personal; - Atësia - Datëlindje; - Gjinia; - Vendbanimi (adresa);	Në formë elektronike.
9	<b>Byroja Shqiptare e Sigurimit</b>	Ligji nr. 10 076/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ndryshuar.  Kodi i Procedurës Civile, neni 154,  Rregullorja nr. 53/2009 e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”	Të dhënat si më poshtë: Vendbanimi (adresa)/ vendqëndrimi për personat (shkaktarë /përfitues) të një procedure dëmshpërblimi ;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
10 <sup>2</sup>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</b>	Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, nenet 38, 39, 76, 78.  Vendimi nr. 209, datë 6.4.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, nenet 10, 11, 12, 18, 19, 38, 49, 73.	Të dhënat që lidhen me identifikimin e të dënuarit si dhe të dhënat e nevojshme për takimet, vizitat dhe lejet e veçanta si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për plotësimin e dosjes/dokumentacionit të personit në paraburgim apo të burgosur.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.

<sup>2</sup> Ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.189, datë 04.10.2022, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjëndjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

11	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore</b>	Ligj nr. 102 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numri personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa). - “të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
12	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave</b>	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar. - Neni 21 “Organizimi i autoritetit përgjegjës”; - Neni 22 “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”.	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numri personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendlindje; - Gjendja civile; - Gjinia; - Lidhja me kryefamiljarin; - Përbërja familjare aktuale dhe historike.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

13	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor</b>	<p>Kodi Rrugor, miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar.</p> <p>Udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2012 “Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove të tyre”, i ndryshuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri personal;</li> <li>- Emër;</li> <li>- Mbiemër;</li> <li>- Mëmësi</li> <li>- Datëlindje;</li> <li>- Vendlindje;</li> <li>- Shteti i lindjes;</li> <li>- Numri i letërnjoftimit ID;</li> <li>- Lloji letërnjoftimit ID;</li> <li>- Data e lëshimit të letërnjoftimit ID;</li> <li>- Data e skadencës letërnjoftimit ID;</li> <li>- Adresa.</li> </ul>	Në formë elektronike.
14	<b>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar</b>	<p>Ligji Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar. Pika 4 e nenit 25 “Krijimi dhe detyrat”</p> <p>Ligji Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Germa a, neni 37 “Detyrat e grupit të punës” Neni 39 “Procedura për kontrollin e figurës”</p> <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e personelit””. Pika 4, neni 3 “Përkufizime dhe parime të përgjithshme” Neni 5 “Detyrimet e autoriteteve verifikuese dhe të institucioneve të tjera shtetërore” Neni 10 “Dokumentacioni bazë i aplikimit për pajisje me CSP” Neni 12 “Kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë” Neni 13 “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë” Neni 19 “Rrethi i personave që verifikohen”</p>	<p>Të dhënat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Emër;</li> <li>- Mbiemër (Para ose pas martese)</li> <li>- Numri Personal;</li> <li>- Atësi;</li> <li>- Amësi;</li> <li>- Datëlindje;</li> <li>- Vendlindje;</li> <li>- Vendbanimi (adresa);</li> <li>- Gjendja civile;</li> <li>- Të dhënat që përmban certifikata familjare;</li> <li>- Shtetësia;</li> </ul>	Në formë elektronike.
15	<b>Enti Kombëtar i Banesave</b>	<p>Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Akti normativ nr.3 datë 01.03.2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish – pronë e subjekteve të shpronësuar”</p>	<p>Të dhënat që përmban certifikata familjare, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Emër</li> <li>- Mbiemër</li> <li>- Numër personal</li> <li>- Atësi</li> <li>- Amësi</li> <li>- Datëlindja</li> <li>- Gjendja Civile</li> <li>- Vendlindje</li> <li>- Shtetësi</li> <li>- Vendbanimi (Adresa)</li> </ul>	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.



16	<b>Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor</b>	Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” - Neni 5 “Personat e siguruar”; - Neni 27 “Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar”, paragrafët 5 dhe 6.	Të dhënat që përmban: - Certifikata personale, - Certifikata familjare - Certifikata e lëshuar nga akti i vdekjes.	Në formë elektronike.
17	<b>Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave</b>	Neni 9/1 dhe neni 26 i ligjit nr.9046, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar,  Neni 9 dhe neni 42 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
18	<b>Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)</b>	Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 42 “Pagesat për vdekje “Pagesa për vdekje i jepet: a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtarë të familjes që ai e ka në ngarkim; b) personi që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimi  Udhëzimi nr. 3912, datë 21.6.2004 “Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”. “Ndihma në lekë tërhiqet nga të interesuarit pranë zyrës së financës në bashkinë apo komunën përkatëse kundrejt paraqitjes së certifikatës së vdekjes së të ndjerit me shënimin “Shpenzime varrimi”. Për çdo rast pagese, financa e bashkisë apo e komunës, sipas certifikatës së paraqitur, llogarit masën e ndihmës, si dhe plotëson mandatpagesën.”	Për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët janë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore. Të dhënat që përmban certifikata e vdekjes, si më poshtë: - Emër; - Mbiemër para ose pas martese; - Numër personal; - Atësi; - Amësi - Data e lindjes; - Vendlindje; - Gjinia; - Gjendja Civile - Shtetësia; - Data e vdekjes; - Vendi i vdekjes; - Vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.
19	<b>Instituti i Statistikave</b>	Ligj Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”	Të gjitha të dhënat personale që përmban RKGJC-ja.	Në formë elektronike.
20	<b>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</b>	Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. - Neni 27 “Zonat e administrimit zgjedhor” - Neni 46 “Regjistrimi i zgjedhësve në listat e zgjedhësve” - Neni 48 “Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve” - Neni 56 “Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve”	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

21	<b>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</b>	Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 <i>“Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”</i> Neni 23 <i>“Marrja dhe përdorimi i bazave të tjera të të dhënave”</i>	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
22	<b>Ministria e Kulturës</b>	Ligj nr. 8576, datë 3. 2. 2000 <i>“Përbibliotekat në Republikën e Shqipërisë”</i> , i ndryshuar.	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
23	<b>Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe strukturat në varësi të tyre.</b>	Ligji nr. 65/2014 <i>“Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”</i> , neni 15, pika 1 Ligj nr. 13/2015 <i>“Për Policinë Ushtarake dhe Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”</i> , - Neni 18 <i>“Veprimtaria Informative”</i> - Neni 19 <i>“Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale”</i> Ligji 45/2019 <i>“Për mbrojtjen civile”</i> Ligji nr. 10142/2009 <i>“Për sigurimet shoqërore të ushtarakut, punonjësve të gardës”</i> VKM 793, datë 24.09.2010, i ndryshuar <i>“Për zbatimin e ligjit nr. 10142/2009 “Për sigurimet shoqërore të ushtarakut, punonjësve të gardës etj”</i> Ligj nr.9047, datë 10.07.2003 <i>“Për shërbimin informativ ushtarak”</i> . VKM NR. 103, datë 10.2.2016 <i>“Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm osë të pjesshëm të burimeve njerëzore e material të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtzakonshme.</i> Ligji nr. 80/2015 <i>“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa). Këto të dhëna u përkasin personave për të cilët ka filluar procedimi penal për vepra të parashikuara nga Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
24	<b>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</b>	Ligji nr. 57/2019 <i>“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”</i>	Të dhënat që përmban certifikata familjare.	Në formë elektronike.
25	<b>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</b>	Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007 <i>“Për turizmin”</i>  Neni 15 <i>“Njësitë e qeverisjes vendore dhe detyrat e tyre për turizmin”</i> Neni 17 <i>“Regjistri kombëtar i burimeve turistike”</i>	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
26	<b>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</b>	Ligji nr. 8372, datë 9.7.1998 <i>“Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore”</i> .	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Në formë elektronike.
27	<b>Organet e qeverisjes vendore</b>	Ligj nr. 10019, datë 29.12.2008 <i>“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”</i> , i ndryshuar. Neni 48 <i>“Organi që harton dhe miraton listat”</i>	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë elektronike.

28	<b>Përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja</b>	Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, konkretisht nenet 8 dhe 9.  Vendimi nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.	Të dhënat e domosdoshme, të cilat vlerësohen të nevojshme për plotësimin e qëllimit. Marrësi në kërkesë përcakton qartë qëllimin e marrjes së të dhënave. Transferuesi i të dhënave vlerëson dhënien e sasisë së të dhënave në përputhje me qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
29	<b>Përfaqësuesit dhe avokatët me prokurë</b>	Ligji nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, Neni 3 “Karakteret personal të dhënave” Ligj nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 11	Të dhënat që kanë lidhje me personin që përfaqëson avokati dhe që kanë lidhje me çështjen, ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej tij.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
30	<b>Policia e Shtetit</b>	Ligji nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, - Neni 124 “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale”; - Neni 129 “Detyrimi i institucioneve shtetërore dhe private për dhënie informacioni”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Në formë elektronike.
31	<b>Prefekti i Qarkut Tiranë</b>	Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” neni 8. Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.1 datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin” Udhëzimi Nr.2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/akt nënligjor vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
32	<b>Prokuroria e Përgjithshme</b>	Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar Neni 2 “Respektimi normave procedurale”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin.	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC- së dhe Prokurorisë, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9. 2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

33 <sup>3</sup>	Shërbimi i Provës	Ligji nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, neni 31.	Të dhënat që lidhen me identifikimin e personit nën mbikëqyrje dhe të dhënat e nevojshme për plotësimin e raportit.	Në formë shkresore, sipas kërkesës
34	Shërbimi Informativ i Shtetit	Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar, neni 3	Të dhënat si: - Emri; - Mbiemri; - Atësia; - Amësia; - Numri Personal; - Datëlindja; - Vendlidja; - Vendbanimi (adresa); - Statusi i gjendjes civile; - Shtetësia; - Kombësia; - Të dhënat që përmban çertifikata familjare; - Mbiemri para/pas martesë së shtetasve të gjinive (F/M); - Historiku i plotë/pa afat kohor i regjistrimit dhe ndryshimit të emrave/ gjeneraliteteve të shtetasit; - Data e përditësimit të të dhënave;	Në formë elektronike.
35 <sup>4</sup>	Zyra vendore e Përbarimit Përbaruesi Gjyqësor Privat Zyra e Përbarimit Privat	Ligji nr. 8116 datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 516/a.  Ligji nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor” i ndryshuar, neni 26, “Mbledhja e të dhënave”  Ligji nr. 26, datë 8.5.2019, “Për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat”, neni 24, “Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përbarimit gjyqësor”, neni 36, “Të drejtat e përbaruesit gjyqësor privat”, neni 53 “Marrëdhëniet me të tretët”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe të vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

<sup>3</sup> Ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.189, datë 04.10.2022, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” të Ministrisë së Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

<sup>4</sup> Ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.189, datë 04.10.2022, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” të Ministrisë së Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

36	Noterët	<p>Ligji Nr. 110/2018 “Për noterinë”</p> <p>Neni 62 “Kompetencat e noterit”</p> <p>Neni 96 “Qasja dhe aplikimi nëpërmjet sistemit elektronik në regjistrat elektronikë publikë”</p> <p>Neni 112 “Përmbajtja e dëshmisë së trashëgimisë”</p> <p>Neni 125 “Tërheqja e akteve të gjendjes civile pranë zyrave të gjendjes civile nga noteri dhe aplikimi nëpërmjet sistemit”</p>	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për çeljen e trashigëmisë sipas përcaktimeve të ligjeve	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
37 <sup>5</sup>	Ministria e Drejtësisë	<p>Vendimi nr. 149, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristika të përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësia e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”, pika 10, shkronja “b”, nëndarja “iv”.</p> <p>Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, neni 4.</p> <p>Vendimi nr. 618, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, i ndryshuar .</p> <p>Ligji nr. 10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar, neni 29, pika 5.</p> <p>Ligji nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, neni 10, pika 3.</p>	<p>Të dhënat referenciale të gjendjes civile, si: numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/njësia administrative, adresa.</p> <p>Të dhënat e identifikimit të kërkuarit, si emri, atësia, mbiemri.</p> <p>Të dhëna të gjendjes civile, si emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vendbanimi dhe vendqëndrimi.</p> <p>Të dhëna referenciale të gjendjes civile, si numri personal i identifikimit, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia, adresa.</p>	<p>Në formë elektronike.</p> <p>Në formë elektronike.</p> <p>Në formë elektronike.</p> <p>Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.</p>

<sup>5</sup> Shtuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.189, datë 04.10.2022, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” të Ministrisë të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



ANEKS II

Protokolluar me nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**FORMULAR - KËRKESË PËR MARRJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA REGJISTRAT E GJENDJES CIVILE**

Kërkuesi: Emri i institucionit/organit

Emri i titullarit të institucionit/organit

Adresa

Telefon

Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Përmbajtja e kërkesës:

a) Lloji i të dhënave me karakter personal që kërkohet të merret nga regjistrat e gjendjes civile

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

b) Baza ligjore mbi të cilën bazohet kërkesa (referencë të përmbledhësja e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna me karakter personal nga regjistrat e gjendjes civile)

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

c) Qëllimi për të cilin do të përdoren të dhënat me karakter personal të kërkuara

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Emër, mbiemër dhe nënshkrimi i titullarit dhe vula e institucionit/organit

\_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

ANEKSI III

**DHËNIA E PËLQIMIT TË SUBJEKTIT PËR KONTROLL NË TË DHËNAT PERSONALE NË DOKUMENTACIONIN QË MBAN SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE**

Unë \_\_\_\_\_, pas marrjes së informacionit të detajuar në lidhje me natyrën dhe rëndësinë e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi, si dhe pas marrjes së informacionit të detajuar mbi të drejtat e mia të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, jap pëlqimin tim të lirë për \_\_\_\_\_.

(Subjekti i autorizuar) të ketë të drejtën të kontrollojë të dhënat e mia personale në lidhje me emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe (të dhëna të tjera sipas rastit), në dokumentacionin që mban shërbimi i gjendjes civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi i këtij përpunimi do të jetë ekskluzivisht verifikimi i \_\_\_\_\_.

(Subjekti i autorizuar) \_\_\_\_\_, si kontrollues mund të përhapë ose të vërë në dispozicion të dhënat e mia personale të këta marrës: \_\_\_\_\_, me kusht që kjo përhapje të jetë absolutisht e nevojshme për përmbushjen e shërbimit të kërkuar ose nëse kontrolluesi kryen një përpunim që është thelbësor për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Kontrolluesi ka të drejtë të mbajë të dhënat e mia personale vetëm për një periudhë kohe prej \_\_\_\_ muajsh.

Kontrolluesi është i detyruar të shkatërrojë ose të bëjë anonime të dhënat e mia personale pas përfundimit të kësaj periudhe, përveç kur parashikohet ndryshe në bazë të një dispozite ose të një akti tjetër të veçantë.

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_